

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	81 vite burg në total, SHBA reagon pas vendimit të Hagës: Respektojmë aktgjykimin ndaj ish-krerëve të UÇK-së - Informohu siç duhet
ADRESA	https://radar.al/81-vite-burg-ne-total-shba-reagon-pas-vendimit-te-hages-respektojme-akt-gjykimin-ndaj-ish-krereve-te-uck-se/
BURIMI	radar.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 14:24:24 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 14:03:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ff5ba5f318b250728d476e06632d7050c9f8a9c90829df1279a765300b4b8dcd
TEKSTI	baf5ac274b2d6762f7372a6d64c84996c6fd7a21f5353f50b3eed6fca3abc53d
PAMJA	475ab3943c6409040a6ee4aecf35d4f72cb450b57a806cd02e001b0fcc76c4e4

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c343c537f465c86d3b318da6aea15c75183512b51eb784af5b50ebf1f12cb18f
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	485c8b8c8ba28305218c58e8c7791d525f1a193166e89422b0670a53018cd566
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/c343c537f465c86d3b318da6aea15c75183512b51eb784af5b50ebf1f12cb18f>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

YOU ARE AT: Home » 81 vite burg në total, SHBA reagon pas vendimit të Hagës: Respektojmë aktgjykimin ndaj ish-krerëve të UÇK-së

KRYESORE

Demo

81 vite burg në total, SHBA reagon pas vendimit të Hagës: Respektojmë aktgjykimin ndaj ish-krerëve të UÇK-së

SEPTEMBER 16, 2026



Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë reaguar pas shpalljes së aktgjykimit nga Dhoma e Specializuar të Kosovës në Hagë ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi.

Departamenti amerikan i Shtetit deklaroi se SHBA-ja e respekton vendimin e gjykatës dhe u bëri thirrje të gjitha palëve që ta pranojnë aktgjykimin, duke shmangur çdo retorikë që mund të nxisë tensione.

"Ne e respektojmë aktgjykimin e sotëm të Dhomave të Specializuara të Kosovës", tha një zëdhënës i Departamentit amerikan të Shtetit për Radion Evropa e Lirë.

Uashingtoni theksoi gjithashtu mbështetjen për drejtësinë ndaj të gjitha viktimave dhe familjeve të tyre, si dhe për parimet e llogaridhënies, procesit të rregullt ligjor dhe sundimit të ligjit.

"U bëjmë thirrje të gjitha palëve që ta respektojnë vendimin e gjykatës, të shmangin retorikën nxitëse dhe të vazhdojnë të punojnë drejt një të ardhmeje paqësore dhe demokratike", u shpreh zëdhënësi i Departamentit të Shtetit.

Vendimi i Dhomave të Specializuara të Kosovës u shpall më 16 shtator në Hagë, pas procesit gjyqësor ndaj katër ish-krerëve të UÇK-së. Gjykata i shpalli ata fajtorë për katër akuza për krime lufte, ndërsa i liroi nga akuzat për krime kundër njerëzimit.

Hashim Thaçi dhe Jakup Krasniqi u dënuan me nga 25 vjet burgim, Kadri Veseli me 18 vjet, ndërsa Rexhep Selimi me 13 vjet. Në total, dënimet arrijnë në 81 vite burgim.

Aktgjykimi është i shkallës së parë dhe nuk përbën vendim përfundimtar. Mbrojtja ka paralajmëruar se do ta apelojë vendimin, ndërsa procesi gjyqësor pritet të vijojë në instancat përkatëse.

SHBA

SHARE.

Postimet e reja

81 vite burg në total,
SHBA reagon pas vendim...

SEPTEMBER 16, 2026

"Reforma territoriale nuk
cënon shërbimet", Rama...

SEPTEMBER 16, 2026

Dënimi i ish-krerëve të
UÇK-së, Kurti: Padrejtësi ...

SEPTEMBER 16, 2026

Ministri Gogu pas
vendimit të Hagës: Lufta...

SEPTEMBER 16, 2026

Mos e humb

FOKUS | SEPTEMBER 15, 2026

**Kompania e krijuar tri ditë pas
hapjes së thirrjes për grantet e
startupeve fitoi 6.1 milionë lekë në
fazën e rezervuar për biznese të
paktën 1-vjeçare**

Pas shpalljes së listës së fituesve të "Grant
2026" kanë nisur të dalin rastet ku...

**Skema sesi IUTE zbras
fitimin nga Shqipëria, që
ju merr konsumatorëve
me interesa mbi 30%!**

**Skandal me sallamin në
dyqanet Conad, thirrje
konsumatorëve ta kthejnë
mbrapsht**

**6 milionë euro të Startup
Albania: Përfituesit, qokat
dhe "problematikët"**

Na ndiq

Facebook

Instagram

RRETH NESH



Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

NIPT: M47705501A

Email: radarlajme@gmail.com

Kontakt: +355689008000

HOROSKOPI

Universi ka një surprizë për këto 3 shenja më 14 shtator

Një ditë me surpriza në dashuri:
Horoskopi për të gjitha shenjat

Pak dramë, shumë ndjenja:
Horoskopi i dashurisë për këtë javë



Aleanca për
Media
Etike

Artikull joetik?

raporto këtu